

14 prill 2026,
Prishtinë

Bazuar në Rregulloren për Punën e Komisionit të Ankesave dhe të Arbitrazhit të Federatës së Basketbollit (FBK) të datës 31.01.2025, dhe Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore (PG) të datës 20.08.2025, si dhe sipas Ankesës së KB Golden Eagle Ylli të datës 13.04.2026, Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit i FBK-së (“KAA”), me datë 14.04.2026 merr këtë:

V E N D I M

- I. Hedhet poshtë si e PA-LEJUESHME Ankesa e KB Golden Eagle Ylli të datës 13.04.2026.

A R S Y E T I M


Më datë 13.04.2026, Komisioni i Arbitrazhit i FBK-së, përmes postës elektronike, nga Sekretarja e FBK, ka pranuar Ankesën e KB Golden Eagle Ylli të po të njëjtës datë, ndaj Informatorit Nr. 1/2025-26 i Play-off të ProCredit Superliga të datës 13.04.2026 (tash e tutje “Informatori”), përkatësisht ndaj shqiptimit të dënimit sipas nenit 52.3 të PG, me gjobë prej 300 € dhe suspendim për një ndeshje, ndaj lojtarit Lis Shoshi (tash e tutje “Ankesa”).

Në këtë kuadër, KAA ka mbajtur takim lidhur me çështjen në fjalë, më 14.04.2026, dhe ka shqyrtuar Ankesën e KB Golden Eagle Ylli. Sipas kuptimit të KAA, KB Golden Eagle Ylli sfidon Informatorin e KG të identifikuar më sipër duke aluduar ndër të tjera, se vendimi i Komisionit të Garave është i pabazuar në rrjedhën reale të incidentit të dokumentuar me video-incizim, se lojtari kundërshtar është iniciues i kontaktit fizik dhe i veprimeve provokuese, dhe se dënimi ndaj lojtarit Lis Shoshi është jo-proporcional dhe i shkëputur nga konteksti faktik i ngjarjes, për rrjedhojë duke kërkuar shfuqizimin e gjobës dhe suspendimit apo rishqyrtimin e plotë të rastit.

KAA vëren nga provat në shkresat e lëndës, se KB Golden Eagle Ylli ka dorëzuar brenda afatit ankesën e tyre ndaj Informatorit të KG. Njëheri, KB Golden Eagle Ylli ka paguar edhe taksën obligative për parashtrim të ankesës. Megjithatë, ankesa nuk përbën lëndë të lejueshme për trajtim nga KAA, në kuptim të nenit 9 paragrafi 3.1 të Rregullores për Punën e KAA-së të FBK-së, i cili parashikon hedhjen poshtë të ankesës si të palejueshme kur ajo nuk përbën lëndë për shqyrtim. Kjo pasi që vendimi i kontestuar ka të bëjë me masë të shqiptuar sipas nenit 52.3 të Propozicioneve të Garave, e cila, sipas dispozitave në fuqi të PG, përkatësisht neni 52.23, nuk i nënshtrohet ankimimit dhe nuk mund të jetë objekt shqyrtimi, duke e bërë ankesën të palejueshme *ratione materiae*.

Prandaj, KAA nuk ka hyrë në shqyrtimin material të çështjes, dhe duke u mbështetur në atë që u tha më lartë, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni i Arbitrazhit:



Partin Pruthi
Anëtar



Korab R. Sejdiu
Kryetar



Lulzim Fushtica
Anëtar

Prishtinë, 14 prill 2026



Vendimi i dërgohet:

- KB Golden Eagle Ylli
- Komisionit të Garave të FBK-së
- Anëtarëve të Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit
- Arkivit të FBK-së

Këshilla Juridike:

Vendimet e Arbitrazhit janë definitive, dhe kundër tyre nuk është e lejuar ankesa brenda FBK-së. Palët e pakënaqura me vendimin e KAA kanë të drejtë të ankesës tek Këshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS) dhe në Gjykatën kompetente përkatëse.